

URDHËR
Nr. 2, datë 8.1.2020

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, z. Pëllumb Abeshi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të autoritetit kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2020.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Drejtori i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit, z. Pëllumb Abeshi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTËR I TURIZMIT
DHE MJEDISIT
Blendi Klosi